

VENDIM
Nr. 17/2024

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIN E PAGAVE
TË PUNONJËSVE ME KOHË JO TË PLOTË PUNE TË KOMISIONIT QENDROR
TË ZGJEDHJEVE, QË REKRUTOHEN PËR PERIUDHËN PASZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës; të nenit 19, shkronja “m”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore për realizimin e procesit zgjedhor, për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, ku KQZ-ja ka detyrim hapjen e kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, si dhe përpunimin e dokumentacionit administrativ.

II. Struktura, organika dhe klasifikimi i pagave të personelit me kohë jo të plotë pune, që rekrutohet për realizimin e procesit të hapjes së kutive të votimit dhe kutive të materialeve zgjedhore, si dhe përpunimin e dokumentacionit administrativ. për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 15.2.2024.

Lidhja 1

Njësitë përgjegjëse	Pozicioni punës	Kategoria e pagës	Periodha e punësimit	Nr. i punonjësve	Kriteret e punësimit
Sektori i Protokollit dhe Arkivës	DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE, EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE				
	Drejtoria e Burimeve Njerëzore				
	Specialist/Protokoll-Arkivi	IV-2	12 muaj	8	Arsim i lartë
	Specialist/ Protokoll-Arkivi	IV-2	2 muaj	7	Arsim i lartë
	Operator/Arkivi	V	12 muaj	2	Arsim i detyruar
Sektori i Materialeve Zgjedhore	Operator/Arkivi	V	2 muaj	7	Arsim i detyruar
	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE				
	Drejtoria e Logjistikës dhe Digjitalizimit				
	Specialist	IV-2	2 muaj	10	Arsim i lartë
	Punëtor logjistike	III	2 muaj	30	Arsim i detyruar
Sektori i Zhvillimeve Digjitale	Specialist IT	IV-2	2 muaj	3	Arsim i lartë/ Informatikë/TIK/Shkenca Kompjuterike
	Operator	V	2 muaj	3	Arsim i detyruar
Sektori i Administrimit të të Dhënave Digjitale	Specialist/Magazine IE	IV-2	2 muaj	4	Arsim i lartë/ Informatikë/TIK/Shkenca Kompjuterike
	Operator/Magazine IE	V	2 muaj	6	Arsim i detyruar
Total				80	